



Pranuar / Dorezuar Punijeno/Prodato Received/Delivery	23 . 12 2021	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix
SKIMSHK	6309/2021	Sasia Kolicina Quantity
		115



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.961/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti-anëtar, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit me numër A.nr.1424/20, të datës 19.11.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.167/2020 të datës 19.06.2020 të parashtruar nga ankuesi të cilin me autorizim e përfaqëson avokati Komuna e Lipjanit, kundër organit të punësimit/Policia e Kosovës, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 22.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.167/2020 e datës 19.06.2020 e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër protokolli Nr.03/02-131/20 i datës 06.04.2020 i Komisionit për Ankesa të Policisë së Kosovës.

Arsyetim

Ankuesi i punësuar në Policinë e Kosovës, me datë 19.06.2020, ka parashtruar ankesë me numër protokolli 1203/2020, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokolli 03/02-131/20 të datës 06.04.2020 të Komisionit për Ankesa në Policinë e Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, më datë 25.06.2020 ka dorëzuar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit në Policinë e Kosovës, ndërsa Këshilli me datë 15.07.2020 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 22.07.2020 përmes Njoftimit me numër protokoll 1403/2020, ka njoftuar ankuesin se nuk mund të vendos lidhur me ankesën A.Nr.167/2020 të datës 19.06.2020, për shkak se Këshilli nuk ka anëtarë, dhe ka udhëzuar të njëjtin mbi të drejtën e inicimit të procedurës gjyqësore në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative me datë 19.11.2021 ka nxjerr Aktgjykimin me numër A.nr.1424/2020, me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, duke anuluar njoftimin e datës 29.07.2020 të KPSHMCK-se dhe ka obliguar Këshillin që në afat prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën e ankuesit A.nr.167/2020 të datës 19.06.2020.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave pas konstatimit se ankesa është e pranueshme sipas nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike dhe për vendosje meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 1203/2020 të datës 19.06.2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 25.06.2020; Njoftimin e datës 22.07.2020; Autorizimet e datës 06.12.2021 për ankuesit; Autorizimi i datës 17.08.2020; Vendimin e Komisionit për Ankesa i Policisë së Kosovës me Nr.03/02-131/20 të datës 06.04.2020; Ankesën kundër njoftimit të Drejtorisë së Personelit lidhur me përmirësimin e koeficientit dhe kompensimin e diferencave në koeficient për tri (3) vite në mënyrë retroaktive i datës 06.03.2020; E-mailin e datës 21.02.2020; Vendimin e Komisionit për Ankesa i Policisë së Kosovës me Nr.03/02-36 të datës 28.01.2020; Ankesën e ankuesit të datës 23.12.2019; Konkursin me nr. Reference 07/1-01R/06/19; Konkurs me nr. Reference 07/1-01R/04/17; Konkurs me nr. Reference 07/1-01R/02/18; Vendimin për sistemim për kohë të pacaktuar i datës 03.12.2019; Përgjigjen në ankesë e datës 15.07.2020; Kontratën për Kohë të Pacaktuar stafi civil e datës 10.08.2009; Formularin e Përshkrimit të Detyrave të Punës i datës 04.09.2015; Vendimin për sistemim për kohë të pacaktuar i datës 03.12.2019; E-mailin e datës 05.12.2018; Kartelën e nëpunësit civil; E-mail nga F.A. Përgjigjen në ankesë; E-mailin e datës 13.01.2020; Rregulloren (MPB) Nr.02/2017 për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës të Policisë së Kosovës; Strukturën Organizative të datës 31.01.2017; Udhëzimin Administrativ Nr.02/2018 mbi marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës; E-mail nga C.Z. për F.A. i datës 02.12.2021; E-mail nga D.D. për C.Z. i datës 03.12.2021; E-mail nga F.A. për T.M. i datës 13.02.2021; Aktgjykimin me numër A.nr.1424/2020 i Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar Aktgjykimin A.Nr.1424/2020 të datës 19.11.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe pas analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, konstatoi së është e pa bazuar ankesa e ankuesit
sepse:



Bazuar në shkresat e lëndës Kolegji ka gjetur se ankuesi sipas Kontratës së Punës me numër 07/1-01A/0097 së datës 16.07.2013, ka qenë e emëruar në pozitën e punës Përkthyes Shqip – Serbisht dhe anasjelltas, në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme, me pagë fikse prej 326.04 Euro, ndërsa me Vendimin me Nr. Reference 07/1-01SAP-P/10542 të datës 03.12.2019, ankuesi është sistemuar për kohë të pacaktuar në pozitën e njëjtë të punës në Drejtorinë e Personelit, me pagë fikse prej 423.85 euro dhe shtesë në pagë prej 25.00 euro.

I pakënaqur me këtë vendim ankuesi me datë 24.12.2019 parashtron ankesë në Komisionin e Ankesave të Policisë së Kosovës, më kërkesën që të anulohet Vendimi Nr.reference 07/1-01SAP-P/10542 i datës 03.12.2019 ose i njëjti të rishqyrtohet ashtu që ankuesit t'i aprovohet koeficienti i pagës në nivelin e Zyrtarit të lartë të Përkthimeve dhe t'i kompensohet diferenca e pagës për tri vite në mënyrë retroaktive.

Komisioni i Ankesave i Policisë së Kosovës, me Vendimin me numër protokollit 03/02-36 të datës 28.01.2020 ka aprovuar pjesërisht ankesën e ankuesit dhe lëndën e ka rikthyer në rishqyrtim tek Drejtoria e Personelit të Policisë së Kosovës.

Drejtoria e Personelit me datë 21.02.2020, ka njoftuar ankuesin se në zbatim të Vendimit të Komisionit të Ankesave ka parashtruar kërkesë në Ministrinë e Administratës Publike që të aprovohet koeficientin e pagës të njëjtë me pozitë të njëjtë në institucionet tjera të shërbimit civilë, duke shtuar se derisa sa nuk ka aprovim nga kjo Ministri përgjegjëse, Policia e Kosovës nuk mund të vendos lidhur me ndryshimin e koeficientit.

Ankuesi serish me datë 06.03.2020, parashtron ankesë në Komisionin e Ankesave të Policisë së Kosovës, i cili me Vendimin me numër protokollit 03/02-131/20 të datës 06.04.2020 ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pabazuar.

Ankuesi brenda afatit ligjor ushtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore që vendimi i kundërshtuar është i padrejtë dhe në kundërshtim me vendimet e më hershme të këtij Komisioni i cili për këtë çështje të njëjtë ka vendosur ndryshe duke ju referuar Vendimit me nr.422-Aa-2019 të datës 28.01.2020, kërkon që Këshilli ta aprovohet ankesën si të bazuar, duke i njohur të drejtën e kompensimit në mënyrë retroaktive.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, lidhur me pretendimet ankimore të ankueses ju referuar dispozitave të Ligji Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 3 paragrafi 1 ku është përcaktuar se: *1. E drejta e nëpunësve civilë për pagë të drejtë dhe të rregullt është e garantuar në bazë të kushteve të përcaktuara me këtë ligj dhe me Ligjin e Shërbimit Civil*, ndërsa neni 9 paragrafi 1 i po këtij Ligji përcakton se: *Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin pagën bazë për numrin e orëve të përcaktuara me aktin e kantatës së punës*, dhe rrjedhimisht konstatoj se e drejta në pagë është e drejtë themelore nga marrëdhënia e punës dhe nëpunësi civil gëzon të drejtën e realizimit të pagës të përcaktuar në aktin e themelimit të marrëdhënies së punës. Në kuptim të kësaj bazë ligjore dhe duke marrë parasysh shkresat e lëndës, Kolegji ka konstatuar se ankuesi sipas Vendimit me numër 07/1-01SAP-P/10542 të datës 13.02.2019 është sistemuar në pozitë të njëjtë ashtu siç ka qenë i emëruar me Kontratën e Punës me numër 07/1-01A/0097 të datës 16.07.2013 dhe i njëjti realizon pagën në vlerën e përcaktuar me vendimin për sistemimin e tij me kohë të pacaktuar. Andaj, meqenëse Kolegji në provat e lëndës nuk ka gjetur ndonjë kontratë apo akt tjetër administrativ të organit të punësimit përmes të cilës ankuesit i është njohur pozita e



Zyrtarit të Lartë të Përkthimeve kështu që Kolegji vlerëson se pretendimi ankimor për anulimin e Vendimit me numër protokollit me Nr.03/02-131/20 të datës 06.04.2020 të Komisionit për Ankesa në Policinë e Kosovës, si dhe kompensimi i diferencës së pagës në mënyrë retroaktive është i pa bazuar.

Kolegji po ashtu gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se Organi i punësimit gjegjësisht Policia e Kosovës, duke ju referua dispozitave të nenit 7 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunëseve Civil, ka bërë kërkesë pranë ministrisë përgjegjëse për administratë publike, lidhur me ngritje e koeficientit të pagës për disa pozita të punës duke përfshi edhe pozitës e ankuesit, por që një kërkesë e tillë nuk është shqyrtuar nga kjo e fundit.

Bazuar si me lartë, Kolegji konstaton se Komisioni për Ankesa i Policisë së Kosovës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër protokollit 03/02-131/20 të datës 06.04.2020, ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe ka zbatuar drejte ligjin material duke vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Ligjin Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunëseve Civil.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr. 961/2021

Çlirim Zeka

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit avokatit
- Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrativ;
- Drejtorit të Drejtorisë së Policisë së Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Policinë e Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

